



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly



Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (9) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të neneve 10 dhe 13 të Ligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe të nenit 71.1 të Rregullores së Kuvendit në Seancën plenare të mbajtur më 28 shkurt 2019, pas shqyrtimit të Rekomandimit të Komisionit Ad-Hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave, me votim të fshehtë, mori këtë:

**V E N D I M**

1. Kandidatët e propozuar: Birol Urcan dhe Azra Dešić për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komuniteteve tjera, asnjëri nuk i morën votat e nevojshme për tu zgjedhur anëtar në këtë Komision.
2. Të përsëritet konkursi për zgjedhjen e një (1) anëtari të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komuniteteve tjera.

Nr. 06-V- 321

Prishtinë, 28.02.2019

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Vendimi u dërgohet:

- Komisionit të Pavarur të Mediave,
- Drejtorisë për Mbështetje Komisioneve Parlamentare dhe
- Arkivit të Kuvendit.